



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 04 prot.

Kamëz, më 19 .01 2021

V E N D I M

Nr. 04 Datë 19 .01 .2021

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA ADMINISTRATORET SHOQËRORE PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.01.2020 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.04 Datë 14.01.2021** , mbështetur në Ligjin 57 datë 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” nenin 21 të VKM nr. 956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit, për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar, Kreut IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar, Kreut IV pika 3 e VKM nr. 597 datë 04.09.2019, “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”, VKB nr. 158 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike gjatë vitit 2021, për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike” **Këshilli Bashkiak Kamëz :**

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së **muajit Dhjetor 2020, për 66 familje**, që janë rekomanduar nga administratoret shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është **242,240 (dy qind e dyzetë e dy mijë e dyqind e dyzet) lekë**.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij projekt-vendimi paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

K R Y E T A R E

MERITA PRENGA

